



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU  
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.  
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.  
2  
TEL: 0682027818

## MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 9914

Nr. koleksioni: 3243

Tirane më 22/11/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021053950353686138

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE  
NR. 9914 REP.  
NR. 3243 KOL.



MARREVESHJE SIGURUESE

Ne Tirane, sot me date 22/11/2021 (dy mije e njezete e nje), para meje Noterit JULIAN ZHELEGU, Noter i Dhomes se Notereve Tirane paraqiten personalisht:

- I. z. **Fation VEIZAJ**, lindur me 18.09.1966, ne Vlore, me Pasaporte Nr. BC8740581 dhe Nr. Personal G60918033N, banues ne adresen: Rruga "Ismail Qemali", Tirane, perfaqesuar me ane te **Marreveshje Per Zoterimin Pasiv te Kuotave te Kapitalit nga Aksionari date 08.09.2021 nga z.Gentian Priftaj** lindur me 19.12.1975, ne Permet, me Leternjoftim Nr. 034119251 dhe Nr. Personal H51219115J, banues ne adresen: Rrugen "Vace Zela" H.7, Nd.37, Ap.17, Tirane madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenesi**);
- II. znj. **Adriana VEIZAJ** lindur me 05.05.1968, ne Fier me Leternjoftim Nr. 034257193 dhe Nr. Personal G85505231N, banuese ne adresen: Rruga "Ismail Qemali", Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenesi**);
- III. z. **Kujtim KALE**, lindur me 08.10.1979, ne Tirane, me Pasaporte Nr. BG7073527 dhe Nr. Personal H91008132K, banues ne adresen: Rruga "Duresit", P.81, Shk.4, Ap.28, Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet **Barredhenesi**);
- IV. **"BANKA CREDINS" SH.A**, shoqeri shqiptare e regjistruar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, Tirane me Vendimin Nr. 28969, Date 31.01.2003, regjistruar ne organin tatimor me Kodin Fiskal Nr. 3709529, NUIS Nr. K31608801O, si dhe me Licensen e Bankes se Shqiperise Nr.16, date 31.03.2003, e perfaqesuar nga Zv. Drejtor i Departamentit te Biznesit te Madh, znj. **Besa GJEVORI**, lindur me 31.10.1981 me Leternjoftim Nr. 037407190 dhe Nr. Personal I16031030N e njohur personalisht para meje, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar dhe Analist Kredie z. **Klesti BRACE**, lindur me 28.02.1994 ne Erseke, Shqiperi, me Leternjoftim Nr. 036628502 dhe Nr. personal J40228031E i njohur personalisht para meje madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, (dhe ne vazhdim do te quhet **"Barremarresi"**).

Ne kete kontrate, fjalët në njëjës mund të interpretohen në shumës dhe anasjelltas, kurdoherë që një gjë e tillë është e domosdoshme nga përmbajtja e nenit. Termat në gjininë mashkullore nënkuptojnë dhe gjininë femërore dhe anasjelltas.

**Neni 1**  
**Objekti i Kontrates**

1.1 Krijimi i nje barre siguruese mbi pasurite e luajtshme te **Barredhenesit**, si garanci per shlyerjen e kredise se akorduar nga Banka Credins ne baze te **Kontrate Kredie Afatmesme Nr. 6773, Nr. 9912 Rep./ Nr. 3242 Kol., Date 22.11.21** noterizuar nga Noter

**JULIAN ZHELEGU**

**Barredhenesit** vendosi barre mbi kolateralin e pershkruar si me poshte:

1. **100% te aksioneve dhe te drejtat qe lidhen me to qe z. Fation VEIZAJ (50%) dhe z. Kujtim KALE (50%) zoterojne ne shoqerine tregtare "RDA PETROL" SH.A me NUIS Nr. L36629201C me seli ne adresen Rruga "Vaso Pasha", Pallati 13/1, kati 3/D, Tirane si edhe mbi aksionet e reja qe mund te zoterojne ne te ardhmen ne kete shoqeri tregtare.**

**Neni 2**  
**Baza Ligjore**

2.1 Ligji Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Per Barret Siguruese" i ndryshuar, Kodi Civil i Republikes se Shqiperise i ndryshuar.

**Neni 3**  
**Vlefshmeria**

3.1 Marreveshja hyn ne fuqi ditën e nënshkrimit nga palet dhe mbetet ne fuqi deri ne shlyerjen e plote te kredise se bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet dhe shpenzimet e tjera te parashikuara, ne kontraten e kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekset, shtesat dhe/ose ndryshime e saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto.

**Neni 4**  
**Garancite**

- 4.1 Barredhenesi garanton dhe siguron se eshte pronar legjitim dhe i vetem i kolateralit.  
4.2 Barredhenesi garanton Barremarresin se kolaterali, eshte i lire nga cdo barre, detyrim, apo garanci tjetere.

**Neni 5**  
**Detyrimet e barrëdhënësit**

5.1 Gjatë kohëzgjatjes së kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto, per garantimin e te cilave eshte lidhur kjo marreveshje siguroese, Barrëdhënësi është i detyruar te ruaje, te siguroje dhe te mos lejoje perkeqesimin e situates ligjore dhe financiare te kolateralit te bllokuar ne favor te Barremarresit ne perputhje me kete marreveshje siguroese.

5.2 Barrëdhënësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo fakt dhe rrethanë që mund të rrezikojë/perkeqesoje situaten ligjore dhe financiare te kolateralit dhe ose ekzekutimin e tij.

5.3 Barredhenesi ka detyrimin per te njoftuar Banken per cdo konflikt gjyqesor dhe/ose administrativ ne lidhje me kolateralin objekt i kesaj marreveshje siguroese.

**Neni 6**  
**Kompletimi i barres siguroese**

- 6.1 Barra siguroese quhet e kompletuar me permbushjen e sa specifikuar ne Ligjin "Per barret siguroese" i ndryshuar.  
6.2 Barredhenesit me ane te kesaj marreveshje autorizojne Barremarresin te nënshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitoje te gjitha dokumentet e nevojshme ne te gjithë regjistrat perkates te percaktuar nga ligji ku pasqyrohet bllokimi i kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguroese.  
6.3 Barredhenesit do te paguajne shpenzimet per kompletimin, regjistrimin, depozitimin etj e te gjitha dokumenteve te nevojshme ne te gjithë regjistrat perkates te percaktuar nga ligji per efekt te bllokimit te kolateralit me qellim Kompletimin e Barres Siguroese.

**Neni 7**  
**Detyrimet e siguruara**

7.1 Barredhenesit sigurojne me kolateralin:

- i) Pagimin e detyrimit sipas kontrates se kredise specifikuar ne nenin 1 te kesaj marreveshje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve te saj, apo dhe ne rast ristrukturimi te kontrates se kredise si me siper permendur, transformimi nga linje ne kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare ne kredi, etj por pa u kufizuar ne keto;
- ii) Kryerjen e te gjitha veprimeve ligjore qe burojne nga aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne keto marredhenie;
- iii) Pagimin e shpenzimeve per ekzekutimin e kolateralit.



**Neni 8**  
**Ekzekutimi i barres siguruese**

8.1 Ne rastin kur Kredimarrësi është në vonese në pagimin e kesteve mujore së bashku me penalitetet, interesat, komisionet, detyrimet, të parashikuara në kontratën e kredisë të specifikuar në nenin 1 të kësaj marrëveshjeje si dhe anekseve, shtesave dhe/ose ndryshimeve të saj, apo dhe në rast ristrukturimi të kontratës së kredisë si me sipër përmendur, transformimi nga linjë në kredi apo anasjelltas, transformimi nga garanci bankare në kredi, etj por pa u kufizuar në keto, Bankes i lind e drejta për të deklaruar si të kerkueshme për tu paguar të gjithë detyrimet e garantuara me Marrëveshjen Siguruese, si dhe shpenzimet që përfshijnë shpenzimet gjyqësore si dhe çdo shpenzim ligjor deri në ekzekutimin e plotë të tyre, sipas procedurave të parashikuara në Ligjin Nr. 8537, dt.18.10.1999 "Për Barret Siguruese" i ndryshuar.

8.2 Barrëdhënësi, menjëherë pas marrjes së njoftimit nga Banka, do të dorëzojë kolateralin me shpenzimet dhe në përgjegjësinë e tij në çdo vend të përcaktuar nga Banka, bashkë me dokumentet përkatëse. Në rast se Barrëdhënësi nuk e përmbush këtë detyrim, Banka do të vijojë me procedurën e ekzekutimit të parashikuar në Ligjin "Për Barret Siguruese" i ndryshuar.

**Neni 9**  
**Verifikimi i kolateralit**

9.1 Barremarrësi ose agjentet e tij kanë të drejtë të bëjnë inspektime dhe të verifikojnë kolateralin në çdo kohë dhe kohë pas kohe, dhe Barredhënesi është dakort që të ofrojë gjithë asistencën dhe informacionin e duhur mbi gjendjen ekzistuese apo kushtet dhe rrethanat që ndikojnë mbi të.

**Neni 10**  
**Ndalime që kufizojnë të drejtat që lindin nga pronësia**

10.1 Barredhënesi nuk ka të drejtë të ndryshojë apo të krijojë të drejta pronësie ose të drejta të tjera reale mbi kolateralin, ta perdorë atë si kolateral për detyrime të tjera të tashme apo të ardhme, të tyre apo të të tjerëve pa marrë me parë pelqimin me shkrim të Barremarrësit.

10.2 Barrëdhënësi nuk ka të drejtë të anullojë, transferojë, të tjetërsojë apo disponojë, në çfarëdo forme, kolateralin e barrësuar apo të zvogëlojë vlerën e tij pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

**Neni 11**  
**Vazhdimësia e sigurimit të ekzekutimit të detyrimit**

11.1 Në rast se kolaterali humbet, demtohet apo zhvleftehet, si dhe kur Banka çmon se vlera e tij nuk mjafton apo është zvogëluar në vlerë, për të mbuluar detyrimin e siguruar nga kolaterali barremarrësi ka të drejtë të kërkojë shtimin e kolateralit si dhe garanci të plotë nga pasuri të tjera të barredhënesit, ndërsa Barredhënesi ka detyrimin ta shtojë kolateralin me kërkesën me të parë të Barremarrësit.

11.2 Kjo marrëveshje siguruese është titull ekzekutiv.

**Neni 12**  
**Mosmarrëveshjet**

12.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis paleve si rezultat i kësaj Kontrate zgjidhen me mirekuptim, në rast të kundërt kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 13**  
**Ndryshimet**

13.1 Shtesa, ndryshime nga kjo Marrëveshje duhet të behen me shkrim dhe të nënshkruhen nga palët.

13.2 Kjo Marrëveshje së bashku me shtesat apo ndryshimet e saj do të jenë detyruese për barredhënsin dhe trashëgimtarët e tyre respektiv.

**Neni 14**  
**Njoftimi Zyrtar midis Paleve**

14.1 Te gjitha njoftimet dhe komunikimet midis paleve ne kete marreveshje, do te behen me shkrim te dorezuara personalisht ose me poste te regjistruar (rekomande) dhe/ose adresen e e-mail ne adresen e percaktuar ne kete marreveshje.

14.2 Barredhenesit deklarojne dhe pranojne qe te gjitha llojet e njoftimeve te bera ne adresat e deklaruar nga ana e tyre sipas kesaj marreveshje do te konsiderohen si te marra nga ai/ata.

14.3 Barredhenesit jane te detyruar qe te njoftojne menjehere cdo ndryshim ne adresen e tyre. Per sa kohe qe ata nuk kane njoftuar adresen e re, njoftimet do te quhen si te kryera dhe barredhenesit nuk kane te drejte dhe heqin dore nga cdo pretendim ne lidhje me njoftimet e bera ne adresen e deklaruar prej tyre sipas kesaj marreveshje.

Kjo Marreveshje Siguruese hartohet ne 5 (pese) kopje me vlere te barabarte, dhe pasi lexohet dhe gjendet konform vullnetit te lire e te plote te paleve nenshkruhet si me poshte. Une noteri e vertetoj ate sipas ligjit.

**PALET KONTRAKTUESE**

**BARREMARRESI**  
**"BANKA CREDINS" SH.A**  
Zv. Drejtor i Departamentit te Biznesit te Madh  
Besa GJEVORI

*Besa Gjevori*  
*Klesti Brace*

Analist Kredie  
Klesti BRACE



**BARREDHENESI**  
Fation VEIZAJ  
Perfaqesuar nga:  
Gentian PRIFTAJ

*Gentian Priftaj*

**BARREDHENESI**  
Adriana VEIZAJ

*Adriana Veizaj*

**BARREDHENESI**  
Kujtim KALE

*Kujtim Kale*

NOTER

**JULIAN ZHELEGU**

*Julian Zhelegu*